



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 46, datë 21.04.2010

PËR
KRIJIMIN E FONDIT TË KOMPENSIMIT PËR VITIN 2010

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, nenit 45, paragrafi 4, të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, me propozim të Departamentit të Licencimit e Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Në bazë të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, neni 45, “shoqëritë e sigurimit, të cilat ushtrojnë veprimtari në territorin e R.SH në sigurimin e detyrueshëm motorik, janë të detyruara të kontribuojnë çdo vit financiarisht në fondin e kompensimit, në përpjestim të drejtë me primet bruto të shkruara në këto lloj sigurimesh, në vitin paraardhës. Autoriteti, me propozim të Byrosë, vendos çdo vit shumën e kontributeve, sipas pikave 2 e 3 shkronja b, dhe afatin brenda të cilit duhet të bëhet derdhja.

Byroja me shkresën nr. 2150, datë 21.04.2010, ka dërguar vendimin e Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve nr. 62, datë 21.04.2010, me anë të së cilës ka miratuar shumën dhe kontributin e çdo shoqërie sigurimi për fondin e kompensimit për vitin 2010. Autoriteti konstatoi se vendimi i mësipërm është në përputhje me Rregulloren nr. 22, datë 19.03.20010 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e fondit të kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”.

Për sa më sipër Autoriteti,

V E N D O S I:

1. Të miratojë shumën e kontributit të çdo shoqërie sigurimi për fondin e kompensimit për vitin 2010 në vlerën totale 230,186,312 (dyqind e tridhjetë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë e treqind e dymbëdhjetë) lekë, sipas pasqyrës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Brenda datës 30.04.2010, shoqëritë e sigurimit të depozitojnë pranë Byrosë konfirmën bankare lidhur me derdhjen e kontributit.

3. Shfuqizimin e vendimit nr. 115, datë 10.12.2009 dhe vendimit nr. 10, datë 28.01.2010, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
4. Ngarkohet Byroja dhe departamentet përkatës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI